D E K R E T
Nr. 2705, datë 28.7.2000

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË ORGANEVE TË PUSHTETIT VENDOR

Në mbështetje të nenit 92, germa "gj" të Kushtetutës, si dhe të neneve 4,75 dhe 63, të ligjit nr.8609, datë 08.05.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të zhvillohen ditën e dielë, datë 1 tetor 2000.

Në qoftë se në raundin e parë të zgjedhjeve asnjeri prej kandidatëve konkurues nuk fiton shumicën e votave, raundi i dytë të zhvillohet ditën e dielë, datë 15 tetor 2000.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani